

E ti, çfarë TIPI je?
Thirr *110*5# dhe aktivizo
pakon TIP Aktiv.

TIP
AKTIV

200 MIN KOMBËTAR
SMS PA LIMIT
4GB
*110*5#
4.95€



Lajme



Gazeta Express

20/12/2020 11:02

Me i fundit



Raka tregon se si të mbrohemi nga varianti i ri i koronavirusit

Të maskuar e armatosur hajnat bëjnë kërdi në Prishtinë e Podujevë



Dy vjedhje kanë ndodhur në Prishtinë e një në Podujevë, gjatë 24 orëve të fundit. Hajnat të maskuar e nën kërcënim të armëve kanë vjedhur 2 mijë e 400 euro, shkruan Express

Njëri rast ka ndodhur në një bankë në rrugën "Edmond Hoxha" në Prishtinë, ku dy punonjëse kanë lajmëruar policinë se derisa ishin në vendin e punës një person i maskuar dhe nën kërcënimin e armës ka grabitur rreth 500 euro.

Lexo Edhe:

[Raka tregon se si të mbrohemi nga varianti i ri i koronavirusit](#)

"Rr. Edmond Hoxha, Prishtinë 19.12.2020 – 10:20. Ankueset femra kosovare, kanë informuar se deri sa ishin në vendin e punës në bankë, një person i maskuar dhe nën kërcënimin e armës, kishte grabit rreth 500 euro para të gatshme. Nuk raportohet për të lënduar, rasti është duke u hetuar", ka njoftuar Policia në raportin 24 orësh.

Tjetri rast ka ndodhur në rrugën "Bill Clinton", po ashtu në Prishtinë, ku hajnat kanë vjedhur rreth 1 mijë euro.

I dyshuari, derisa ka ikur nga vendi i ngjarjes ka hasur në sigurimin ndaj të ciëve ka shtënë me armë zjarri.

" Rr. Bill Clinton, Prishtinë 19.12.2020 – 10:39. Ankuesja femër kosovare ka informuar se deri sa ishte në vendin e punës, një person i maskuar dhe nën kërcënimin e armës, kishte grabit rreth 1000 euro para të gatshme. Gjatë ikjes, i dyshuari kishte hasur në sigurimin privat, i njëjti ka shtënë dy herë në drejtim të tyre. Nuk raportohet për të lënduar. Në vendin e ngjarjes është gjetur dhe konfiskuar një gëzhgjë", ka njoftuar Policia.

Një rast tjetër i grabitjes ka ndodhur në rrugën "Ilir Konusheci" në Podujevë, mbrëmjen e së shtunës.


Atje, hajnat kanë vjedhur 900 euro në një pompë të derivateve.

"Rr. Ilir Konusheci, Podujevë, 19.12.2020 – 22:50. Viktima mashkull kosovar ka raportuar se deri sa ishte në vendin e punës në pompën e derivateve, një person i dyshuar me maskë dhe nën kërcënimin e thikës i kishte grabitur para të gatshme 900 € dhe ishte larguar nga vendi i ngjarjes. Policia ka dalë në vendin e ngjarjes, nuk raporton për të lënduar por janë duke kërkuar personin e dyshuar", ka bërë të ditur Policia./GazetaExpress/

Share Now



Të ngjashme



Të armatosur e të maskuar, hajnat vjedhin qindra euro në Drenas




Grabitje e armatosur në një institucion financiar në Prishtinë



Hajnat po bëjnë kërdi në Pejë, për pak minuta u grabitën 4 shtëpi vetëm në një lagje



Grabitje e armatosur në Prishtinë




Grabitje nën kërcënimin e thikës në një pompë të derivateve




Hajnat bëjnë kërdi në shtëpinë e mërgimtarit


Te fundit



Raka tregon se si të mbrohemi nga varianti i ri i koronavirusit



Talenti shqiptar shënon dy gola dhe asiston, por Istanbulspori shpërdoron epërsinë e trefishtë



Kaos në bordin e avionit, ndërron jetë pacienti me COVID



Kush është personi i maskuar pas Butrintit



Zëvendëskryeministri i Parë sqaron nga kufiri se mërgimtarët nuk paguajnë Polisën e Sigurimit



Gjykimi për Ukë Rugovën do të fillojë nga pika zero